

UDHËZIM
Nr. 32, datë 17.12.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 7.3.2024, “PËR KRITERET,
PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”; të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar dhe të pikës 5, të VKM-së nr. 130, datë 6.3.2024, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2024”, të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 6, datë 7.3.2024, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun V “DOKUMENTACIONI QË GJENEROHET NGA REGJISTRAT ELEKTRONIK DHE MODULI I PUNONJËSVE QEVERITAR”:

a) Në paragrafin e parafundit, togfjalëshi “jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga afati i përfundimit të aplikimeve” zëvendësohet me togfjalëshin “jo më vonë se data 28.2.2025”.

2. Në kreun VIII/II. “PROCEDURAT E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES, VERIFIKIMIT DHE EKZEKUTIMIT TË PAGESAVE PËR MASAT 9–13”:

a) Në pikën 4, togfjalëshi “45 ditëve kalendarike nga afati i përfundimit të aplikimeve” zëvendësohet me togfjalëshin “datës 28.2.2025”;

b) Në pikën 5, togfjalëshi “afatit 45 ditë kalendarike nga afati i përfundimit të aplikimeve” zëvendësohet me togfjalëshin “datës 28.2.2025”.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj